

FORMATI MARC21

Formati MARC (lexo: mark) është sistem i kodimit të të dhënave bibliografike, të njësive të ndryshme të informacionit, qofshin ato libër, periodik, disketë, mikrofilm, hartë, burime të Internetit, etj. Termi MARC qëndron për *MA*chine *R*eadable *C*atalog (katalogu i lexueshëm nga kompjuteri). Numri 21 qëndron për shekullin XXI.

Për dallim nga rregullat e ndryshme bibliografike, si ISBD, AACR2, etj., të cilat tregojnë se si dhe ku duhet të merret informacioni për ta bërë përshkrimin e materialit, formati MARC mundëson, që në bazë të atyre rregullave, informacionet të futen apo strukturohen duke përdorë kode të veçanta në atë mënyrë që t'i bëjë të mundur kompjuterit t'i kuptojë dhe manipulojë ato të dhëna. Përderisa në katalogun tradicional, për t'i ofruar përdoruesit mundësi të shumta për kërkimin e një të njësie bibliografike, duhej të krijoheshin katalogë të ndryshëm (p.sh. një katalog alfabetik, sistematik, lëndor, topografik etj. - disa skeda për të njëjtën njësi bibliografike), katalogu elektronik, duke shfrytëzuar formatin MARC, u ofron përdoruesve mundësi të shumta kërkimi duke e shndërruar njësinë bibliografike në një njësi dinamike apo interaktive në katalogun elektronik. Me një fjalë formati MARC ka bërë zëvendësimin dhe shndërrimin e skedave në letër, në skeda elektronike me strukturë të përshtatshme për natyrën e kompjuterit. Edhe pse sot ekzistojnë disa lloje formatesh të ndryshme të kodimit të informacionit, për shkak të traditës së përdorimit të gjatë nëpër biblioteka, formati MARC ende mbetet formati më i përdorur i metadatave në biblioteka. Formatu MARC21 është krijuar nga Biblioteka e Kongresit, dhe versioni i plotë në anglisht mund të gjendet në faqen zyrtare të Formatit MARC21: <http://www.loc.gov/marc/>.

Për listën e kodeve të vendit në formatin MARC, kliko:

http://www.loc.gov/marc/countries/cou_pt1names.html

Për listën e kodeve të gjuhës në formatin MARC21, kliko:

http://www.loc.gov/marc/languages/lang_pt2.html

Ekzistojnë dy forma të formatit MARC 21:

- 1) Formatu MARC21 për njësitë bibliografike, dhe
- 2) Formatu MARC21 për njësitë e autorizuara.

Formatu MARC21 për njësitë bibliografike përdoret për të koduar informacionin e gjetur në burim sipas rregullave të katalogimit; ndërsa, Formatu MARC21 për njësitë e autorizuara shërben për të zbatuar kontroll sidomos mbi përcaktueset kryesore (emra personal, të korporatave, uniform, etj.), përcaktueseve lëndore (termave, dhe hierarkisë së atyre termave), përcaktueseve shtesë, etj. Në të vërtetë formatu MARC21 për njësitë e autorizuara funksionon, me një fjalë, prapa perdes, duke u dhënë përdoruesve një mjet të fuqishëm të kërkimit të informacionit.

Formatu MARC21 për njësitë bibliografike

Struktura e formatit MARC21 për njësitë bibliografike është si vijon:

	Numri udhëheqës dhe udhëzues
008	Fusha e kontrollit
01X-04X*	Fushat e numrave dhe të kodeve
05X-08X	Fushat e klasifikimit dhe të renditjes
1XX	Fushat e përcaktuesve kryesorë
20X-24X	Fusha e titullit dhe fushat e tjera lidhur me titullin
25X-27X	Fushat e ribotimit, shtypit etj.
3XX	Fushat e përshkrimit fizik etj.
4XX	Fushat e serive
50X-53X	Fushat e shënimeve: pjesa 1
53X-58X	Fushat e shënimeve: pjesa 2
6XX	Fushat e përcaktuesve lëndorë
70X-75X	Fushat e përcaktuesve shesë
76X-78X	Fushat e krijimit të lidhjeve
80X-830	Fushat e përcaktuesve shesë të serive
841-88X	Fushat e vendndodhjes, paraqitjes alternative grafike etj.

Për më tepër shih: Formati MARC21 për njësitë bibliografike.

Shënim: Vini re, se shifra (X) më lart, paraqet një numër të mundshëm në radhë, p.sh. 01X=010, 011, 012, etj.

Formati MARC21 për njësitë e autorizuara

Struktura formatit MARC21 për njësitë e autorizuara është si vijon.

0XX	Numrat standard, numrat e klasifikimit, kodet
1XX	Përcaktueset (të autorizuar dhe referencat)
2XX	Shih referencën (komplekse)
3XX	Shih po ashtu këtë referencë (komplekse)
4XX	Shih referencën
5XX	Shih po ashtu këtë referencë
6XX	Shënimet
7XX	Përcaktueset lidhëse
8XX	Paraqitja alternative grafike
9XX	Të rezervuara që të modifikohen për nevojat e bibliotekës

Për më tepër shih: Formati MARC21 për njësitë e autorizuara.